



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY SH.A

Data \_\_. \_\_. 2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Karburant**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **09100000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**1,630,800 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albanian Seaports Development Company sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Leje tregtimi ose autorizim për tregtim karburanti e lëshuar nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “ Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera” me ndryshimet përkatëse (për të dyja stacionet e tregtimit me pakicë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

• Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës përlllogaritur të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlere jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufij të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi, kontratën pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

**2.3.2** Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht **2(dy)** stacione të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Durrës, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas kodit civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesmarrës;

- Stacionet e tregëtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur me Autorizim ose Liçencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë).
- Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit B të lëshuar nga QKL.
- Vërtetim Teknik lëshuar nga ISHTI ose organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit (OMVK),
- Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga MZSH dhe "Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në zbatim të ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 ‘PËR LEJET E MJEDISIT’ ; Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Ky kriter është vlerësuar i nevojshëm pasi i shërben autoritetit kontraktor për të vërtetuar nëse operatori ekonomik i suksesshëm ka kapacitetet e duhura për të garantuar furnizimin me karburant 24 orë, në një distancë relativisht të përballueshme për Institucionin.

Para vendosjes së këtij kriteri NJHD ka bërë hetim të tregut dhe ka konstatuar se ka një numer operatorësh që kanë më shumë se 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Durrës.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizë për produktin Gazoil 10 PPM S SH EN:590:2013:2017, lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) në Republikën e Shqipërisë, shoqëruar me Deklaratën Doganore SAD të produktit të furnizuar gjatë 6 (gjashtë) muajve të fundit, nga data e hapjes së ofertave i cili duhet të jetë në përputhje me standardet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike. Fletë analiza të jetë e lëshuar brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar dhe/ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2022 deri ditën e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjit Nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Ky kriter është i rëndësishëm, pasi garanton AK-në që Operatori Ekonomik ofertues ofron cilësi duke respektuar standardet Ligjore si dhe respekton normat dhe të gjitha masat mbrojtëse duke ofruar produkt sipas standarteve bashkëkohore. Vërtetimi i lëshuar nga ky institucion na siguron që ofrohet furnizim cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatën ISO 9001: 2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.
- Certifikatën ISO 14001: 2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.
- Certifikatën 45001: 2018 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

**2.3.6** Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- a) Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, ose me tollon, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit me tollon deri në përfundimin e plotë të kontratës sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Karta elektronike duhet të jetë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- b) Bazuar në VKM nr.561 datë 29. 07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet autoriteti kontraktor.

Disponimi /ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara më sipër do të demonstron nga ana e operatorëve ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë në prani të anëtarëve të KVO-së së Autoritetit Kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

*Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage) që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën shkak për skualifikim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet.

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajmë në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasisë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”

### Specifikimi i Materialeve:

#### **Naftë gazoil-10ppm, sipas Standartit AL ST EN 590:2013+A1:2017 ose Ekuivalent SSH EN 590:2022**

Të dhënat teknike të Gazoil 10 PPM i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH): Lëndë djegëse për automjete – Karburant diezel (Gazoil) sipas AL ST EN 590:2013+A1:2017 ose Ekuivalent SSH EN 590:2022

#### **Specifikimet teknike të Gazolit (Naftë)**

- Lëndë djegëse për automjete – Karburant diezel (Gazoil) sipas **AL ST EN 590:2013+A1:2017 ose Ekuivalent SSH EN 590:2022**

Tabela 1-kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburantet automotive

Substanca	Njësia matëse	Limitet (normat)		Metoda e provës (shih klauzolës 2)
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	EN ISO 5165 EN 15195 EN 16144
Indeksi Cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 gradë celcius	Kg/m <sup>3</sup>	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarbure Polycyclic aromatike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtje Mangani Deri 31-12-2013 Nga 01.01.2014 në vazhdim	mg/l	- -	6,0 2,0	Pr EN 16576

Pika e ndezjes	Gradë celsius	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Karboni i mbetur (në 10% mbetje distilati)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Kontaminimi total	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celsius)	Grada	Grupi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester FAME	% (V/V)	-	7,0	EN 14078
Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m <sup>3</sup> h	- 20	25 -	EN ISO 12205 EN 15751
Lubrifikimi, diametri i veshjes së mprehte (ësd 1,4) në 60 gradë Celsius	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 gradë Celsius	Mm <sup>2</sup> /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi % (V/V) rafinimi në 250 gradë celsius % (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius 95 % (V/V) rafinimi në	% (V/V) % (V/V) Gradë celsius	85	Më pak se 65 360	EN ISO 3405 EN ISO 3924
<b>Shënim: Kërkesat me Bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70 /EC (1), duke përfshirë amendamentet 2003/17/EC (2), 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4).</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Shih gjithashtu 5.7.1.</li> <li>b. Shih gjithashtu 5.7.4.</li> <li>c. Shih gjithashtu 5.7.2.</li> <li>d. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.</li> <li>e. Shih gjithashtu 5.7.3.</li> <li>f. Shih gjithashtu 5.2.2.</li> <li>g. Shih gjithashtu 5.2.2. dhe Aneksi A.</li> <li>h. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN.</li> <li>i. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3).</li> <li>j. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME , qëndrueshmëria e oksidimit e përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të.</li> <li>k. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V) nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.</li> <li>l. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE.</li> <li>m. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.</li> </ul>				

***Grafiku i lëvrimit të karburantit***

Nr	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	KARBURANT	litra	10,000

- Afati kohor për furnizim me karburant do të jetë 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
- Vlefshmëria e kartës elektronike do të jetë edhe pas mbarimit të afatit të kontratës, deri në përfundim të sasisë së karburantit.